



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 843

Datë: 12/3/2020

Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 17 të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 12.03.2020, nxjerr:

VENDIM

1. Deri në përfundimin e periudhës së pezullimit të procesit mësimor të caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të gjitha aktivitetet e zgjedhjeve për Këshilla të Studentëve dhe Parlament të Studentëve do të zhvendosen për aq ditë sa do të zgjasë pezullimi.
2. Shtyrja e aktiviteteve sipas dinamikës zgjedhore, për aq ditë sa do të zgjasë pezullimi i procesit mësimor, i caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, do të zbatohet edhe për zgjedhjet e personelit akademik dhe jo akademik në nivel të përfaqësimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
3. Këshilli Drejtues, autorizon KQZ-në që të zbatojë një dinamikë të re zgjedhore, duke pasur parasysh numrin e ditëve sa do të zgjasë pezullimi i procesit mësimor, i caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës si dhe numrin e ditëve për të cilat është zbatuar dinamika e miratuar nga KQZ-ja, pas shpalljes së zgjedhjeve nga Këshilli Drejtues, sipas vendimit nr.613, datë 28.02.2020.
4. Pas përfundimit të pezullimit të procesit mësimor të caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, KQZ do të njoftojë Këshillin Drejtues për fillimin e zbatimit të dinamikës të procesit zgjedhor, nga momenti i pezullimit.
5. Moszbatimi i këtij vendimi, sanksionohet sipas nenit 250 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i UP-së, menjëherë pas shpalljes së COVID-19, si pandemi globale nga Organizata Botërore e Shëndetit, vendimit të datës 11.3.2020, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për pezullim të procesit mësimor nga data 12 mars 2020 deri më 27 mars 2020, me qëllim të shmangies së çfarëdo rreziku për shëndetin e studentëve, personelit dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të Fakulteteve;
3. Sekretarëve të Fakulteteve;
4. Menaxhmentit të UP-së;
5. KQZ-së dhe
6. Për publikim në ueb-faqe të UP-së.



Dr. Sc. Shkëlzen Bajra

Kryesues i Këshillit Drejtues të UP-së